



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME – VRHOVNI SUD

GJS-2025-003

Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës – Fejzullah Rexhepi, bazuar në nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 6 i Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga pala N.H., kundër gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Pejë, V.M., më datë 19.02.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET SI E PABAZUAR, ankesa e palës N.H., kundër gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Pejë, V.M..

A r s y e t i m

Në Gjykatën Supreme më datë 21 janar 2024 dhe 19 shkurt 2025, përmes Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë, janë pranuar ankesat e palës N.H., kundër gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Pejë, V.M., për shqyrtim të pretendimeve tek Kryetari i Gjykatës Supreme si Autoritet Kompetent, konform nenit 9 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Pala ankuese, ndaj gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Pejë, V.M., ka paraqitur ankesën e tij me pretendimet se gjyqtari i rastit nuk ka marr parasysh kërkesën e tij kur ka shkuar dhe ka kërkuar shtyrje të seancës për një ditë tjetër, citoi ankesën e tij “*për shkak vdekjes së një komshiu, 100 vjeçar, se sikur mos të kisha shku isha korit dhe isha bë përrallë në fshat*” dhe se në këtë rast gjyqtarin e ka njoftuar se do të shkoj në varrim nga ora 14:00 dhe nuk mund të marr pjesë në seancën gjyqësore, në këtë rast pretendon se gjyqtari në fillim nuk foli, nuk kishte sjellshme të hijshme dhe se më zë të vogël i tha “veç me parashtresë. Tutje, në ankesën e dytë

të parashtruar ndaj gjyqtarit, pretendon se ka filluar një konflikt interesi me gjyqtarin në një lëndë ku ai ishte paditës ndërsa gjyqtari, në atë kohë ishte avokat i palës së paditur, duke shtuar se në një lëndë tjetër ka ndikuar tek një gjyqtar për të mos caktuar masën e sigurisë dhe se ky është gjyqtar që vepron si i thotë ndokush, duke pretenduar tutje se gjyqtari i apostrofuuar bën pazare dhe me gjyqtarë të tjerë dhe me prokurorë për prona të tij.

Lidhur me pretendimet e palës, kryetari i Gjykatës Supreme, si autoriteti kompetent ka analizuar dhe shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës si dhe ankesën e ankuesit, lidhur me këtë rast dhe vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar.

Pas shqyrtimit të këtyre pretendimeve, kryetari i Gjykatës Supreme ka vlerësuar se të njëjtat janë të pambështetura në fakte dhe prova. Për këtë arsye, pretendimet e palës nuk përbëjnë bazë të mjaftueshme për të filluar një procedurë disiplinore ndaj gjyqtarit V.M..

Pretendimet e palës ankuese, të paraqitura me ankesë, të cilat lidhen me refuzimin e kërkesës për shtyrjen e seancës dhe një konflikt interesi të mundshëm, nuk përkojnë me arsyet për të cilat mund të iniciohet një rast disiplinor ndaj një gjyqtari. Kjo për shkak se, ankuesi ka ngritur pretendime dhe ndaj gjyqtarit të pambështetura në fakte dhe prova konkrete. Andaj, kjo ankesë si e tillë është jo serioze dhe dukshëm të pabazuar.

Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në mënyrë shprehimore në nenin 5, ka paraparë rastet në të cilat konsiderohet se është kryer shkelje disiplinore, në rastin konkret rezulton se veprimet e gjyqtarit V.M., nuk kanë konsumuar ndonjë nga shkeljet e parapara me këtë Ligj.

Andaj, për shkak se në parashtrësën e palës, nuk potencohet ndonjë shkelje konkrete e supozuar disiplinore, të cilat janë të parapara në nenin 5 të ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Fejzullah Rexhepi

Kryetar i Gjykatës Supreme

Kopje:

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
2. Gjyqtarit,
3. Palës ankuese,
4. Arkivit të Gjykatës Supreme.